

**STATUT/AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"DIGID M.I.S "**

Ne baze te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME
FORMIMI I SHOQERISE
NENI 1**

1 . Shoqeria tregtare **"DIGID M.I.S "** shpk me seli ne adresen Tirane Rruga Beri Karapici Kompleksi Golden Park kati 2 Hyrja 8 Tirane, formohet nga ortakët themelues:

Z. Ugur Yedikardes , i datelindjes 04.03.1983 , lindur ne Kadikoy , banues ne Stamboll /Turqi, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me numer identifikimi personal U25270749 , referuar ne vazhdim si Ortak i shoqerise.

Z. Mustafa Emrah Kuyumcu , i datelindjes 16.09.1982, lindur ne Iskenderun , banues ne Stamboll /Turqi, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me numer identifikimi personal S21187236, referuar ne vazhdim si Ortak i shoqerise.

te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe ne perputhje me ligjin "PER SHOQERITE TREGTARE", REGJISTRIN TREGTAR si dhe AKTIN E THEMELIMIT ka vendosur te destinoje ne kete sipermarrje kapitalin e tij vendas, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e shoqerise, si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

2. Shoqeria e ushtron veprimtarine ne baze te ekonomise se tregut te lire.

3. Shoqeria eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar duke u pajisur me lejen e ushtrimit te te profesionit nga zyra e qendres kombetare te regjistrimit (QKB)te rajonit perkates.

4. Shoqeria tregtare **"DIGID M.I.S "** shpk fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit te saj prane zyres se qendres kombetare te regjistrimit(QKR).

**FORMA, EMERTIMI
NENI 2**

1. Shoqeria Tregtare eshte e organizuar si Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

2. Emertimi i Shoqerise eshte **"DIGID M.I.S "** shpk.

3. Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare mund te ruhet i njehti emertim, me kusht qe personi juridik te shtojë ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.

4. Shoqeria zoteron dhe perdor marken, simbolin dhe vulen e saj me emrin **"DIGID M.I.S "** ose **"DIGID M.I.S "** ose **"DIGID M.I.S "**. Keto nuk mund te zoterohen apo perdoren nga pale te tjera si vendas apo te huaj pa miratimin me shkrim te asamblese se ortakëve te kesaj shoqerie.

**SELIA
NENI 3**

Selia e shoqerise **"DIGID M.I.S "** shpk ndodhet ne Tirane, Tirane Rruga Beri Karapici Kompleksi Golden Park kati 2 Hyrja 8 Tirane. Albania. Shoqeria mund te krijojë filiale, dege e perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise ashtu dhe jashte territorit te saj sipas nevojave. Selia mund te ndryshohet/transferohet ne cdo vend tjeter me vendim te Asamblese se



Ortakut/eve, i cili ratifikohet nga mbledhja e afert e asamblese se zakonshme. Keto vendime depozitohen ne Regjistrin Tregtar.

NEN1 4

KOHEZGJATJA

1. Shoqeria tregtare **"DIGID M.I.S"** shpk do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar.
2. Ndryshimet duke perfshire edhe edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje personaliteti juridik te ri.

OBJEKTI

NENI 5

Shoqeria **"DIGID M.I.S"** sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Çeshtjet e Lidhura me Softuerin dhe Teknologjine e Informacionit:

- a) Automatet e shitjes, makinat e biletave, makinat per terheqje parash, kioska dhe sistemet e automatizimit, pajisjet POS dhe ato per regjistrimin e pagesave, elementet elektronike te perdorur ne makina dhe pajisje, sherbimet kompjuterike, studime shkencore dhe industriale, sherbime kerkimore, sherbime inxhinierike, dizajn ueb, dizajn CD, zhvillim softueresh, instalim sistemesh dhe sherbime te rrjeteve, projekte interaktive CD, sisteme per menaxhimin e permbajtjes, faqe interneti korporative, aplikacione celulare korporative, zhvillim, shitje dhe menaxhim i çdo lloj sistemi dhe softueri te automatizuar.
- b) Blerja dhe shitja e kompjutereve, importimi dhe eksportimi i tyre, montimi, riparimi, mirembajtja dhe servisi i tyre. Prodhimi, tregtimi, importimi dhe eksportimi i pjeseve rezerve te kompjutereve, si dhe montimi i tyre.
- c) Blerja dhe shitja e çdo lloj materiali per kompjutere, zhvillimi i programeve kompjuterike dhe marrja e licencave per to.
- d) Pergatitja, riparimi dhe rregullimi i te dhenave, ofrimi i ketyre sherbimeve per shitje ose me qira, si dhe publikimi i tyre ne internet.
- e) Mbledhja dhe perditesimi i te dhenave, si dhe ofrimi i sherbimeve keshilluese.
- f) Ofrimi i çdo lloj sherbimi ne fushen e teknologjise se informacionit, sistemeve kompjuterike, mbeshtetjes per softuer dhe pajisje, si dhe sherbimeve te konsulences.
- g) Zhvillimi i softuerave, implementimi dhe ofrimi i sherbimeve te trajnimit.
- h) Krijimi i sistemeve kompjuterike dhe blerja me shumice ose pakice, shitja, shperndarja, importimi, eksportimi dhe montimi i çdo lloj pajisjeje elektrike dhe elektronike.
- i) Pergatitja e raporteve te fizibilitetit, ofrimi i sherbimeve inxhinierike, keshillimore, mbeshtetese dhe te servिसimit per individe, kompani private dhe institucione publike per zgjedhjen e softuerave dhe pajisjeve kompjuterike.
- j) Zhvillimi i produkteve, dizajnimi i produkteve, automatizimi, kerkimi dhe zhvillimi (R&D), konsulenca ne teknologji dhe sisteme, si dhe ofrimi i zgjidhjeve teknologjike.

Çeshtjet e Lidhura me Konsulencen:

- a) Ofrimi i sherbimeve te konsulences ne fushen e strategjise, financave, marketingut, prodhimit, proceseve te biznesit, burimeve njerezore, menaxhimit te projekteve dhe aspekteve te markes tregtare dhe te te drejtave te ekskluzivitetit per çdo organizate.
- b) Ofrimi i trajnimeve ne lidhje me strategjine, financat, marketingun, prodhimin, proceset e biznesit, burimet njerezore, menaxhimin e projekteve dhe te drejtave te markes tregtare dhe ekskluzivitetit.
- c) Menaxhimi i operacioneve te çdo biznesi ne platformat softuerike, perditesimi i te dhenave, administrimi i proceseve dhe vleresimi i kerkesave te klienteve.

U.K.

U.41

Veprimtari te tjera te Shoqerise:

1. Shoqeria mund te bleje, shese, operoje, jape ose marre me qira pasuri te paluajtshme, te krijoje te drejta reale mbi to, te vendose ose te heqe hipoteka, te kryeje çdo transakcion me pronat ne perputhje me legjislacionin.
2. Mund te bleje, shese ose marre hua me ose pa kolateral pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, te jape ose te marre garanci, te vendose ose te heqe rehin dhe hipoteka, si dhe te kryeje çdo transakcion financiar te nevojshem per realizimin e objektivave te saj.
3. Mund te aplikojë per dhe te transferojë patenta, marka tregtare, licenca, modele industriale dhe te drejta te tjera te pronesise intelektuale, si dhe t'i jape me qira ose t'i marre me qira ato.
4. Mund te bleje, zhvilloje dhe shese prona te paluajtshme, si dhe te investoje ne ndertimin e tyre.
5. Mund te marre hua dhe kredi nga institucione te ndryshme financiare, vendase dhe te huaja, per financimin e projekteve te saj.
6. Mund te bleje, importojë, eksportojë dhe jape me qira pajisje, makineri dhe mjete transporti per veprimtarine e saj.
7. Mund te marre pjese ne tendere, te krijoje ose te behet pjese e agjencie, perfaqesive, komisioneve, distribucionit dhe aktiviteteve te tjera tregtare.
8. Mund te krijoje kompani te reja, te bashkepunoje ose te investoje ne kompani ekzistuese.
9. Mund te bleje dhe te investoje ne letra me vlere, bono dhe aksione te kompanive te tjera, duke respektuar ligjet ne fuqi.
10. Mund te bleje lende te para dhe produkte te gatshme per t'i perpunuar dhe tregtuar.
11. Mund te bashkepunoje me kompani dhe institucione vendase dhe te huaja per zhvillimin e projekteve te perbashketa.
12. Mund te marre dhe te jape perfaqesi, shperndarje dhe agjenci nga kompani vendase dhe te huaja.
13. Mund te marre pjese ne tendere dhe projekte te ndryshme, brenda dhe jashte vendit.
14. Mund te kryeje operacione importi dhe eksporti, duke respektuar legjislacionin ne fuqi.
15. Mund te ofroje ose te marre sherbime te punes fason.
16. Mund te krijoje, te operoje, te jape ose te marre me qira magazina frigoriferike per ruajtjen e mallrave.
17. Mund te marre pjese ne panaire, ekspozita dhe aktivitate te tjera promovuese, brenda dhe jashte vendit.

Nese kompania vendos te zhvilloje aktivitate te tjera te cilat konsiderohen te dobishme dhe te nevojshme ne te ardhmen, keto aktivitate mund te kryhen pas vendimit te bordit te ortakeve dhe regjistrimit te ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

NENI 6

Shoqeria Tregtare **"DIGID M.I.S "** sh.p.k., nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomike-tregtare qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj.

Ky kapital depozitohet sipas ligjit. Ne librin e llogarise te Shoqerise krijohet fondi themeltar ku shenohet kapitali i ortakeve.

NENI 7

KAPITALI

Kapitali themeltar eshte 100.000(njeqindmije) Leke, i ndare ky ne ,

Ugur Yedikardes me nje kuote me perqindje ne pjesemarrje 50 me vlere 50.000 leke

Mustafa Emrah Kuyumcu me nje kuote me perqindje ne pjesemarrje 50 me vlere 50.000 leke

NENI 8

Shoqeria ka te drejte te krijoje fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik dhe tregtar.

NENI 9

1. Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante percaktohen nga ortaket sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2. Te ardhurat e pergjithshme te shoqerise dhe ne pergjithesi cdo operacion financiar i saj do te pasqyrohet ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

NENI 10

1. Shoqeria tregtare **"DIGID M.I.S"** sh.p.k., eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te marre, te perdore, te bleje apo shese dhe te shfrytetoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates.
3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike, apo kontabiliteti dhe juridike paguhen vetem nga fondet e shoqerise.

NENI 11

1. Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te ortakeve te hartuara nga ortaket dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me vendim te ortakeve.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithte ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

NENI 14

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakeve.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me ane te kontributeve ne para dhe ne natyre apo zvogelimi i tij behet me vendimin e ortakeve mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar.

NENI 16

ORTAKERIA



Ortakët e shoqërisë tregtare "DIGID M.I.S" sh.p.k., gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin pjesë për të gjitha detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në aktin e themelimit dhe në statutin e shoqërisë.

NENI 17

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE.

1. Të marrin pjesë në mbledhjet e asamblese së ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës.
2. Të paraqesin pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit.
3. Të informohen mbi përgatitjen e raportit të administrimit, inventaret e llogarive vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel.
4. Të përfitojnë nga fitimi i shoqërisë.
5. Të kërkojnë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara.

NENI 18

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

1. Shoqëria do të administrohet nga një Administrator i zgjedhur nga Ortaku i Shoqërisë. Si Administrator i shoqërisë do të zgjidhet **Ugur Yedikardes dhe Mustafa Emrah Kuyumcu**, me një afat 5 vjeçar, e cila përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet. Administratori do të kryejë të gjitha veprimet zyrtare të shoqërisë.
2. Shoqëria, në të ardhmen mund të administrohet edhe nga një Administrator tjetër, i cili emërohet me Vendim të Ortakut/eve.
3. Administratori, mund t'i delegojë kompetencat e tij (pjesërisht ose të gjitha) me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
4. Vendimet e ortakëve, evidencohen në një regjistër të vecantë.

NENI 19

ASAMBLEJA

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë:

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në statut.
 2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë.
 3. Të vendosë për zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
 4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë.
 5. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë.
- Procesverbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

NENI 20

TE DREJTAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka keto të drejta.

1. Të mbikëqyrë dhe të kontrollojë gjithë veprimtarinë e shoqërisë.
2. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet, në administratën publike dhe organet gjyqësore.
3. Të emërojë personelin e domosdoshëm.
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë.
5. Të thërrasë asamblet dhe të vendosë rendin e dës.
6. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe të paraqesë ato për miratim asamblese së ortakëve.

NENI 21

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të treteve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

MRK

U.4,

NENI 22

1. Shoqeria **"DIGID M.I.S"** sh.p.k., mund te emeroje ne vazhdimesi nje ekspert kontabel per nje afat kohor te percaktuar me te drejte rizgjedhje.
2. Emerimi kryhet nga ortaket.
3. Per kompetencat, shkarkimin dhe shperblimin etij zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 23

MARRREDHENIET E PUNESIMIT

1. Te gjithë personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, punesimi i tyre do te behet ne baze te kontrates individuale te punes ose kolektive, ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin vendas ne kete fushë.
2. Marrja ne pune behet me ane te regjistrimit nga ana e punedhenesit ne librin e punes se shoqerise.
3. Largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga administratori. Largimi nga puna lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljes disiplinore ose me kerkesen e te interesuarit.
4. Mos marreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise do te zgjidhen me mirekuptim, ose kur ky i fundit nuk eshte i mundur palet do ti drejtohen gjykates kompetente perkatese.

NENI 24

BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQERISE

1. Shoqeria tregtare **"DIGID M.I.S"** sh.p.k., me ane te bashkimit mund ti kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ato themelojne dhe qe ushtron te njejtin aktivitet.
2. Shoqeria tregtare **"DIGID M.I.S"** sh.p.k., me ane te ndarjes mund ti kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ezistuese ose shoqerive te reja.

NENI 25

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE.

1. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfare do lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privimi te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga ortaket.
2. Shoqeria hyn ne fazen e e likujdimit qysh ne momentin e prishjes se saj.
Per kete, ortaket emerojne nje ose me shume likujdator.
3. Shoqeria priset ne keto raste:
 - Kur nuk mund te permbushet objekti per te cilin eshte krijuar.
 - me vullnetin e ortakeve.
 - me vendim te gjykates.
 - kur mbaron afati i veprimtarise se shoqerise.

NENI 26

DISPOZITA TE FUNDIT

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut do te aplikohet ligji **"PER SHOQERITE TREGTARE"** si dhe legjislacioni ne fuqi.

NENI 27

Ky statut hyn ne fuqi dite e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtarne qendren kombetare te regjistrimit(QKB).

NENI 28

MRK

U.4,

Ky statut perpilohet ne 3 kopje origjinale me te njejten vlere ligjore perktheu **Aida Albayrak** i njohur dhe pranuar nga ortakët.

Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin e shoqerise.

ORTAKET THEMELUES

Ugur Yedikardes



**Perkthyesë
Aida Albayrak**

Mustafa Emrah Kuyumcu

